

Përshëndetje,

Në përgjigje të kërkesës suaj për informim të datës 07.12.2023, ju bëjmë me dije se, nga të dhënat e administruara nga Departamenti i Administratës Publike (DAP), për znj. N.P., njësia përgjegjëse ka nxjerrë gjithsej dy akte emërimi, përkatësisht:

-Aktin nr. 3885 prot., datë 21.07.2023, lënda "Emërim", në pozicionin Jurist në Avokaturën e Shtetit - kategoria III-b.

-Aktin nr. 4527 prot., datë 08.09.2023, lënda "Emërim", në pozicionin Specialist në Sektorin e Ankesave Administrative dhe Gjyqësore, në Drejtorinë e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e Mbrojtjes - kategoria: III-b.

Për sa i përket kërkesës suaj për t'ju vënë në dispozicion kopje (mundësisht të njësuar me origjinalin) të akteve të emërimit, të znj. N. P., ju bëjmë me dije se në nenin 14, të Ligjit nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit", të ndryshuar, përcaktohet se:

"1. Të gjitha kërkesat për informacion trajtohen, si rregull, nëpërmjet konsultimit pa pagesë të informacionit në mjediset e autoritetit publik, nëpërmjet portalit unik qeveritar e-albania.al apo, kur është rasti, nëpërmjet faqes zyrtare të autoritetit publik në internet.

2. Kërkesat, që lidhen me dokumente të shkruara, trajtohen duke vënë në dispozicion të kërkuarit: a) një kopje të plotë, në format të njëjtë me atë të përdorur nga autoriteti publik, përveç rasteve të veçanta; b) një kopje të plotë të informacionit nëpërmjet postës elektronike, kur informacioni gjendet në një formë të tillë ose mund të konvertohet.

3. Lidhur me kërkesat që lidhen me forma të tjera, informacioni jepet në mënyrën më të efektshme dhe me koston më të ulët për autoritetin publik.

4. Në çdo rast, vendimi i refuzimit për formën e kërkuar jepet me shkrim dhe i arsyetuar."

Për sa më sipër, DAP iu ka informuar për aktet e kërkuara, por është në kushtet e pamundësisë për t'ua vënë në dispozicion këtë informacion në formën e kërkuar, pra duke përcjellë kopjet e akteve të emërimit, pasi bazuar në pikën 1, të nenit 17, të Ligjit nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit", të ndryshuar, znj. N. P., në cilësinë e titullarit të së drejtës nuk ka dhënë pëlqimin për përcjelljen e akteve.

Për më tepër, nga të dhënat që disponon DAP, informacioni i kërkuar lidhet me një proces gjyqësor ku jeni palë paditëse dhe DAP është palë e paditur, me objekt procedurën e ndjekur në shpalljen nr. 4663 për pranim në shërbim civil. Rezulton se për këtë proces gjyqësor ka përfunduar gjykimi në shkallë të parë, por nuk kemi një vendim të formës së prerë dhe nëpunësi për të cilin ju kërkonit informacion është një palë e interesuar, e cila ka marrë pjesë në procedurën e rekrutimit, objekt gjykimi, si dhe do ndikohej nga rezultati i këtij gjykimi.

Në zbatim të gërmës "dh", të pikës 2, të Ligjit nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit", të ndryshuar, ku përcaktohet mundësia e kufizimit të drejtës së informimit për të mbrojtur barazinë e palëve në një proces gjyqësor dhe mbarëvajtjen e procesit gjyqësor, DAP vlerëson se dhënia e informacionit në formën e kërkuar nga ana juaj do të cënonte këto interesa.

Qëndrimi i DAP-it mbështetet dhe në nenin 3, të "KONVENTËS SË KËSHILLIT TË EVROPËS PËR AKSESIN NË DOKUMENTE ZYRTARE Tromsø, 18.VI.2009", ratifikuar me Ligjin nr. 45/2022 "Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës "Për aksesin në dokumente zyrtare"". Në këtë dispozitë përcaktohet se:

*"1. Secila Palë mund të kufizojë të drejtën e aksesit në dokumente zyrtare. Kufizimet duhet të përcaktohen saktësisht në ligj, të jenë të nevojshme në një shoqëri demokratike dhe proporcionale, me synim mbrojtjen e: a) sigurisë kombëtare, mbrojtjes dhe marrëdhënieve ndërkombëtare; b) sigurisë publike; c) parandalimit, hetimit dhe ndjekjes penale të veprimtarisë kriminale; d) hetimeve disiplinore; e) inspektimit, kontrollit dhe mbikëqyrjes nga autoritetet publike; f) **privatësisë dhe interesave të tjera legjitime private**; g) interesave tregtare dhe interesave të tjerë ekonomike; h) politikave ekonomike, monetare dhe valutore të shtetit; i) **barazisë së palëve në procedimet gjyqësore dhe administrimit të efektshëm të drejtësisë**; j) mjedisit; ose k) diskutimeve brenda apo ndërmjet autoriteteve publike në lidhje me shqyrtimin e një çështjeje. Shtetet e interesuara, në momentin e nënshkrimit ose depozitimit të instrumentit të tyre të ratifikimit, pranimit, miratimit apo aderimit, me anë të një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, mund të deklarojnë se komunikimi me familjen mbretërore dhe oborrin e saj ose kreun e shtetit, duhet gjithashtu të përfshihet midis kufizimeve të mundshme.*

*2. **Akresi në informacionin në përmbajtje të një dokumenti zyrtar mund të refuzohet, nëse zbulimi i tij mund ose ka të ngjarë të dëmtojë interesat e përmendura në paragrafin 1, nëse nuk ka një interes publik më të lartë në lidhje me zbulimin e tij.***

3. Palët duhet të marrin parasysh caktimin e afateve kohore pas të cilave kufizimet e përmendura në paragrafin 1 nuk zbatohen më."

Si përfundim, sjellim në vëmendjen tuaj se nëpunësit civilë nuk mund të privohen nga e drejta për një jetë private apo të drejta të tjera të përcaktuara në ligj. DAP në çdo përgjigje ndaj kërkesave për informim, detyrohet të balancojë si të drejtën për informim të kërkuarit dhe të drejtat e personave të tretë që lidhen me informacionin e kërkuar, duke u përgjigjur në atë formë që nuk cënon asnjë nga këto interesa.

Kërkesa juaj për informim është regjistruar në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve 2023 të DAP-it, me numrin rendor 20, sipas detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", të ndryshuar. Për çdo kërkesë tuajën për informim ju mund t'i drejtoheni adresës së kontaktit të pasqyruar në faqen tonë zyrtare: info@dap.gov.al. Kjo përgjigje do dërgohet dhe me shkrim në adresën postare të caktuar nga ana juaj.

Faleminderit për mirëkuptimin